



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:104474

Datë: 27.09.2024

Numri i dokumentit: 06263160

KF.nr.640/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në kontestin tregtar - administrativ të paditësit “Dauti Komerc” ShPK me seli në Ferizaj, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimit, objekti i kontestit ndëshkim administrativ, vlerë e kontestit 1,125.00 euro, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor- publik, të mbajtur me 19.09.2024 në prani të përfaqësuesit të autorizuar të palës paditëse Granit Ajeti, dhe në mungesë të përfaqësuesit të palës së paditur, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësit “Dauti Komerc” ShPK me seli në Ferizaj, si e bazuar.
- II. ANULOHET vendimi nr.156/2022 i datës 22.04.2022, i Departamentit të Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës dhe lënda kthehet në RISHQYRTIM DHE RIVENDOSJE tek e paditura.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi, me padinë e paraqitur në Gjykatë, ka inicuar kontestin tregtar-administrativ kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), duke kërkuar që të aprovohet në tërësi si e bazuar padia dhe të anulohet vendimi nr.156/2022 i datës 22.04.2022. ka shtuar se e paditura nuk ka mund të dëshmoj shkeljen e ndodhur, ose të bashkëngjit një vendimi-dëshmi ku thuhet se nuk është mbajtur dokumentacioni dhe fatura e pasaktë, andaj pretendimet e të paditurës ku thuhet

se në bazë të aktivitet të inspektorit, është vizituar pas ankesës së qytetarit për lëshimin e një fature të pa saktë, që rezulton edhe në mos mbajtje të dokumentacionit sipas ligjeve në fuqi, besojmë se janë pretendime të pabazuara, për arsye se për sa i përket lëshimit të faturës së pasaktë, ne nuk lëshojmë fatura të pasakta, gjithashtu posedojmë evidencën e dokumentacionit me tepër se afati i përcaktuar ligjor pasi që ne jemi kompani parimore dhe nuk kemi pasur kur qëllime të shmangies apo përfitimit të pa ligjshëm.

E paditura, në përgjigje të padisë, i ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e paraqitura, duke i konsideruar si të pabazuara në ligj dhe në fakte materiale. ATK-ja ka vlerësuar se vendimi i saj nr. nr.156/2022 i datës 22.04.2022 është mbështetur ligjërisht dhe faktikisht, dhe është në përputhje të plotë me legjislacionin tatimor të aplikueshëm në Republikën e Kosovës. Tutje, ATK-ja ka shtuar se vendimi i kontestuar ka mbështetje të mjaftueshme ligjore dhe faktike. Gjykatës i ka propozuar të refuzoj kërkesëpadinë si të pabazuar dhe të lë në fuqi vendimin e kontestuar.

Gjykata ka shqyrtuar këtë kontest tregtar-administrativ në përputhje me dispozitat e nenit 41 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA-së), duke e mbajtur seancën në mungesë të palëve ndërgjyqëse, pasi paditësi e ka pranuar ftesën për këtë seancë me datë 16.08.2024, por mungesën-mos prezencën nuk e ka arsyetuar, ndërsa e paditura e ka pranuar ftesën për seancë, por me parashtesën e datës 09.09.2024, e ka njoftuar gjykatën se nuk do të prezantojë në këtë seancë. Ajo ka kërkuar që gjykata të veprojë në përputhje me nenin 38, paragrafi 5, të LKA-së. Po ashtu, e paditura ka propozuar që të lë në fuqi vendimin e Departamentit të Ankesave të ATK-së, vendimi nr. nr.156/2022 i datës 22.04.2022.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata, gjatë shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik, ka administruar provat si në vijim: Përgjigje në padi e datës 26.07.2024, Vendimi nr.156/2022 i datës 22.04.2022, Forma për vizitat përmbushëse e datës 18.03.2022, Ankesa e paditësit në DA të ATK-së e datës 30.03.2022.

Gjykata ka vlerësuar ligjshmërinë e vendimit kontestues, deklaratimet në padi, përgjigjen në padi, deklaratimet gjatë shqyrtimit gjyqësor, shkresat e lëndës dhe secilën provë veç e veç, si dhe të gjitha së bashku dhe mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), Gjykata ka arritur në përfundimin se në këtë konflikt administrativ duhet të vendoset sipas dispozitivit të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar-administrativ, përfshirë deklaratimet në padi dhe përgjigjen në padi, shkresat e lëndës dhe vendimin kontestues, Gjykata ka gjetur se nuk është kontestuese fakti që Zyra për Gjoba dhe Ndëshkime, më 22.03.2022, ka marrë vendimin nr.0517/2022 për shqiptimin e ndëshkimit administrativ në për subjektin tatimpagues, paditësin në këtë rast, për shkak të mos lëshimit mos-krijimit dhe mos-mbajtjes së dokumentacionit në vlerë prej 1,000.00 € dhe për secilën faturë të pasaktë në vlerës prej 125.00 Euro. Po ashtu, fakti që tatimpaguesi këtu paditës ka parashtruar ankesë më datë 30.03.2022 në Divizionin e Ankesave kundër vendimit nr0517/2022 nga Zyra për Gjoba dhe Ndëshkime Administrative, nuk është kontestuar. Gjithashtu, nuk është kontestuese që Administrata Tatimore e Kosovës, Divizioni i Ankesave, më datë 22.04.2022, ka marrë vendimin nr.156/22, si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, duke refuzuar ankesën e subjektit tatimor e të cilin vendim paditësi e ka kontestuar përmes kësaj padie në Gjykatë.

Gjykata pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës konstaton se nga konkluzionet e nxjerra në procedurën administrative dhe provave të theksuara në arsyetimet e vendimeve të paditurës, nuk mund të vërtetohet plotësisht gjendja faktike dhe se ekzistojnë kontradikta në mes konstatimeve të cekura pa i arsyetuar mjaftueshëm me prova konkrete. Gjykata konstaton se vendimi i kontestuar nuk përmban arsye mbi faktet vendimtare, të vlefshme për zgjidhjen e drejtë të çështjes në shqyrtim.

Nga forma e vizitës së përmbushjes së datës 18.03.2022 është konstatuar se qëllimi i vizitës ka qenë për të vërtetuar nëse denoncimi nga “Euro Max” Shpk, për mos lëshim të faturës tatimore nga këtu paditësi. Në raport është theksuar se denoncuesi ka bërë porosinë e disa artikujve: si djath, pudër dhe shampion etj, ka kryer pagesën në vlerë prej 50 euro dhe nuk i është lëshuar fatura tatimore por vetëm dëshmi pagese e thjeshtë (denoncuesi thotë se automjeti/kombi me të cilën bajnë shpërndarjen e mallit as një herë nuk posedojnë fatura). Më tej theksohet se denoncuesi ka kontaktuar biznesin dhe ka kërkuar sqarim për mosëshimin e faturave tatimore sipas tij tatimpaguesi është përgjigjur se për vlera më të vogla se 200 euro nuk lëshojmë fatura tatimore. Më tej Gjykata konstaton se inspektori tatimor ka vizituar këtu paditësin, përkatësisht ka kontaktuar me drejtorin e biznesit z.B.K., të njëjtin e kanë njoftuar për rasti dhe i është bërë me dije se shitja për subjektet e identifikuara duhet të shoqërohet me faturë tatimore pavarësisht vlerës së cekur në faturë. Duke vepruar sipas kësaj vizite, Zyra për Gjoba dhe Ndëshkime Administrative përmes vendimit 0517/2022 të datës 22.03.2022 ka shqiptuar gjobë në vlerë prej

1,000.00 për mos-mbajtje të dokumentacionit dhe për secilën faturë të pasaktë në vlerë prej 125.00 euro. Gjyben e shqiptuar e ka arsyetuar duke u bazuar në nenin 13 par 1 të Ligjit 03/L-222 dhe nenit 17 par të Udhëzimit Administrativ 15/2010 dhe nenin 1 par 1.8 pika 1.8.6 të Ligjit 03/L-222 si dhe neni 27 pika 1.1 të UA 01/2015.

Gjykata konstaton se paditësi duke atakuar vendimin e Zyrës për shqiptimin e gjobave ka pretenduar se posedojmë evidencën e dokumentacionit më tepër se afati i përcaktuar duke shtuar se gjatë inspektimit nuk është mundur të kundërshtohet apo të informohet se për çfarë shkelje (gabime) kanë ndodhur.

Nga vendimi i kontestuar gjykata konstaton se e paditura duke u bazuar në aktivitetin e inspektorit vërteton se tatimpaguesi ka bërë shkelje ligjore në mbajtjen e evidencave në veçanti mos lëshimit të faturës tatimore. Më tej ka arsyetuar se denoncuesi deklaroi se vazhdimisht bën blerje të biznesi “Dauti Comerc” Shpk dhe ky biznes nuk lëshon faturë tatimore por vetëm një dëshmi pagese të thjeshtë. DA në vendimin e kontestuar e rekomandon tatimpaguesin se për çdo transaksion në mes të dy subjekteve tatimore edhe pse është ndër 500.00 euro duhet të lëshohet faturë tatimore sipas nenit 44 dhe 45 të Ligjit nr.05/L-037, për Tatimin e Vlerës së Shtuar. Ankesën e paditësit e ka refuzuar si të pabazuar duke theksuar se vlerëson se ndëshkimet janë lëshuar duke u vërtetuar gjendja faktike në momentin e caktuar kohor dhe në momentin e vizitës konstatohet se subjekti në fjalë ka vepruar në kundërshtim të dispozitave ligjore sipas nenit 13 par 1 të Ligjit 03/L-222 dhe nenit 17 par 3 të UA 15/2010 dhe nenit 1.8 dhe 1.8.6 të Ligjit nr. 04/L-102 dhe 04/L-223 dhe nenit 43 par 94 të UA 15/2010 si dhe nenit 27 pika 1.1 i UA 15/2010.

Për gjykatën, është i paqëndrueshëm pretendimi i të paditurës se paditësi nuk ka lëshuar faturë tatimore sipas denoncimit të një subjekti tjetër, sepse nga provat e administruara gjykatës i rezulton një gjendje tjetër faktike. Gjykata vëren se e paditura ka mbështetur qëndrimin se nuk është lëshuar faturë tatimore vetëm në bazë të denoncimit të një subjekti tjetër, por nga raporti i vizitës nuk mund të konstatohet nëse dëshmia e pagesës i është ofruar në shikim paditësit i cili ka mundur ta kundërshtojë dhe po ashtu nuk mund të vërtetohet nëse paditësit i është kërkuar të dëshmojë të kundërtën. Nga po i njëjti raport konstatohet se pas takimit me drejtorin e tatimpaguesit, të njëjtin e kanë njoftuar për rastin dhe i është bërë me dije se shitja për subjektet e identifikuar duhet të shoqërohet me faturë tatimore pavarësisht vlerës së cekur në faturë, mirëpo nuk dëshmohet se i është ofruar dëshmia dhe kërkuar nga i njëjti ndonjë dëshmi për të argumentuar të kundërtën e denoncuesit. Nga Aktivitetit theksohet se i është bashkangjitur një

foto si dëshmi, megjithatë e njëjta nuk është vlerësuar në asnjë fazë të procedurës administrative qoftë para organit të parë apo të dytë të të paditurës, e po ashtu nuk i është ofruar as gjykatës si dëshmi për të mbështetur vendimet e veta.

Tutje, e paditura nuk ka arsyetuar se pse ka aplikuar paragrafin 2.4, të nenit 53, sepse nuk është sqaruar baza për llogaritjen e ndëshkimit administrativ të paraparë në paragrafin 2. të siç është e përcaktuar me paragrafin 3 të po të njëjtit nen.

Gjykata konstaton se vendimi i kontestuar nuk përmban një vlerësim të fakteve në raport me dispozitat ligjore, dhe si i tillë nuk mund të konsiderohet i drejtë dhe i ligjshëm, pasi nuk është marrë duke respektuar dispozitat ligjore të Ligjit për Procedurën Administrative. Në përputhje me dispozitat e nenit 43 të LKA-së, gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative. Në këtë rast, gjykata vëren se nuk ka dëshmi të mjaftueshme nga ATK-ja për të mbështetur vendimin kontestues dhe për të kundërshtuar pretendimet e paditësit. Si rezultat, gjykata nuk mund të pajtohet me një konkluzion të tillë.

Në përputhje me nenin 43, paragrafi 2, të Ligjit për Konfliktet Administrative, kur gjykata konstaton se konflikti administrativ nuk mund të shqyrtohet në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative, për shkak të kontradiktave ose mungesës së fakteve të plota, gjykata mund të anulojë aktin e kontestuar administrativ dhe ta kthejë çështjen për rishqyrtim. Në këtë rast, organi kompetent është i detyruar të veprojë sipas vërejtjeve të dhëna në aktgjykim dhe të nxjerrë një vendim të ri administrativ.

Gjykata, bazuar në autorizimet nga neni 43, paragrafi 2, i Ligjit për Konfliktet Administrative, obligon të paditurën që në ri-procedurë të veprojë sipas vërejtjeve të dhëna në arsyetimin e këtij aktgjykimi, duke mbledhur prova shtesë dhe duke marrë parasysh faktet e reja. Të gjitha këto veprime duhet të bëhen në përputhje me nenin 81.F paragrafi 2 të Ligjit Nr.04/L-102 të Udhëzimit Administrativ për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat Nr.03/L-222, i cili përcakton se "*Administrata tatimore, doganore ose ndonjë administratë tjetër kompetente do të bartë detyrimin e vërtetimit të fakteve që mbështesin vendimin dhe kundërshtojnë kërkesën e tatimpaguesit.*"

Gjykata obligon të paditurën që të analizojë të gjitha faktet dhe provat relevante dhe të marrë një vendim të drejtë dhe të ligjshëm në përputhje me dispozitat e legjislacionit tatimor të Republikës së Kosovës.

Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar edhe në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Vendimin për shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 64 të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga sa u tha më lart, gjykata, konform nenit 43, paragrafi 2, dhe nenit 46, paragrafët 1, 2 dhe 3, të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal
KF.nr.640/22, datë 19.09.2024

Gjyqtarja

Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.